

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-215/2015**

**Prishtinë,  
10 Maj 2018**

Në çështjen juridike të:

**V. J.**

**Pala ankuese**

kundër

**N.SH. “Agromorava” ( në likuidim)**

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015 të datës 30 mars 2015 (lënda e regjistruara në AKP me numrat: KPA 93453), pas shqyrtimit të mbajtur më 10 Maj 2018, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si të pabazuara ankesa e paraqitura nga V. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/267/2015, lënda e regjistruar në AKP me numër KPA93453.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/267/2015 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA93453.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. V. J. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) me 10 tetor 2006, ka paraqitur Kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (Tutje: KPA) duke kërkuar riposelimin e ngastrës kadastrale nr. 955, me kulturë tokë, në sipërfaqe prej 03.67.83 ha, qe gjendet në fshatin Gushicë, Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: prona e pretenduar). Ai ka deklaruar se familja e tij e ka fituar pronën e pretenduar përmes aktgjykimit për denacionalizimit. Humbja e posedimin ka qenë si rrjedhojë e rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë.
2. Pala ankuese në mbështetje të kërkesës së vet i ka siguruar KPA-së këto dokumente:
  - Aktgjykimi nr. 155/90, i dhënë nga Gjykata Komunale e Vitisë, me 5 dhjetor 1994, me të cilin ishte vërtetuar se Paraqitësit e kërkesës, V. dhe L. J. janë pronarë të ngastrës kadastrale nr. 955, që gjendet tek vendi “Beli Luk” në sipërfaqe prej 03.67.83 ha dhe ngastrën kadastrale nr. 1298/6, që gjendet tek vendi “Beli Luk” në sipërfaqe prej 01.15.62 ha. Që të dy ngastrat kadastrale janë theksuar në fletën poseduese nr. 147 në emrin e Kooperativës Bujqësore në Viti, prandaj ndërmarrja “Agro Morava” në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë ishte e obliguar që të njej të drejtën e pronësisë mbi pronat e theksuara më lartë të palës paraqitëse të kërkesës si dhe të i lejoj paraqitësve të kërkesës që të bëjnë ndryshimet kadastrale, “Zemlji-oradnicka Zadruga/ Koperativa Bujqësore” Viti,
  - Kërkesën e paraqitur në Agjencinë Kosovare të Kadastrit nga L. dhe V. J. për zbatimin e ndryshimeve në kadastër,
  - Certifikatën e vdekjes nr. 203-42/04, të lëshuar me 27 shkurt 2004 nga Zyra e Regjistrimit Civil në Kragujevcë, që tregon se L. J. ka vdekur me 22 shkurt 2004,
  - Mendimin profesionist të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me 10 janar 2005 lidhur me kërkesën e V. dhe L. J. për regjistrimin e të drejtës pronësore në emrat e tyre. Agjencia Kosovare e Kadastrit vërteton se pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara dhe brenda afatit ligjor ka vendosur për kërkesën,
  - Vendimin nr. 245/2007 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë me datë 11 janar 2008 me të cilin gjykata e lejon kryerjen e ndryshimeve kadastrale në emër të V. dhe L. J. Baza ligjore për ndryshim ishte aktgjykimi nr. 155/90. Drejtoria për Kadastër është obliguar që të i zbatoj ndryshimet menjëherë pasi që vendimi është bërë (25 shkurt 2008),
  - Vendimi i kadastrit nr. 489 i lëshuar nga Agjencia Kosovare e Kadastrit me 13 nëntor 2008. Sipas vendimit, kushtet për regjistrimin e të drejtave pronësore në emër të V. dhe L.J. ishin

- përmbushur, por kërkesa për kryerjen e ndryshimeve kadastrale ishte refuzuar për shkak të vendimit të Kuvendit Komunal të Vitisë nr. 013/838, të datës 6 mars 2008, që përkohësisht e shtynë regjistrimin e pronës së paluajtshme në kadastrë për të drejtat pronësore që burojnë nga ish ndërmarrjet shoqërore,
- Vendimi i kadastrit nr. 03/715/69, i lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës me 02 maj 2009, përmes të cilit Ankesa e V. dhe L. J. ndaj Vendimit të Kadastrit nr. 489, ishte refuzuar si e pabazë,
  - Padia nr. 478/09, e paraqitur pranë Gjykatës Supreme të Kosovës nga V. dhe L. J, që të dy në cilësinë e palës kërkuese me 25 qershor 2009 për anulimin e vendimit të kadastrit nr. 03/715/69, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e palës kërkuese si e pabazë.
3. Njoftimi i i Kërkesës është bërë me 1 qershor 2010 përmes publikimit të Kërkesës në Gaztën Zyrtare të KPA-së, nr. 2 të datës 17 qershor 2010 si dhe në Buletinin e zyrës së Pronave të UNHCR-së. Si gazeta ashtu edhe lista u lanë në Komunën e Vitisë, në hyrje dhe dalje të fshatit Gushicë. I njëjti publikim u la në zyrën e kadastrit të komunës së Vitisë, Gjykatën Komunale të Vitisë dhe në zyrën Rajonale të KPA-së në Prishtinë.
4. Agjencia Kosovare e Privatizimit me 29 shtator 2014 (tutje pala përgjegjëse në ankesë) përmes M.S. (Zyrtar Ligjor) iu është afruar KPA duke treguar interesin e tyre ligjor në Kërkesë.  
Pala përgjegjëse në ankesë në mbështetje të Kërkesës dorëzoi këto prova:
- Letrën informuese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit që iu drejtohet Agjencisë Kosovare të Pronës me 29 shtator 2014 duke e njoftuar KPA-në se ndërmarrja “Agromorava” (nën procedurë të likuidimit) është nën administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ndërmarrja “Agromorava” iu është nënshtruar procedurës së likuidimit me 7 korrik 2014 në pajtim me ligjin Nr. 04/6-034. Pronat e kërkuara janë regjistruar në emër të ndërmarrjes “Agromorava”. V. J. ishte njoftuar sa i përket procedurës së likuidimit me 16 korrik 2014 por se nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për pronat e pretenduara,
  - Fletën poseduese nr. 147 të lëshuar nga Komuna e Vitisë, Departamenti për Kadaster, gjeodezi dhe pronë me 15 maj 2007, që i rëndit pronat e pretenduara si prona në pronësi shoqërore nën emrin e ndërmarrjes “Agromorava”.
  - Letrën informuese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nr. 16295, të datës 16 korrik 2014 që e njofton V. J. për procedurën e likuidimit të pronave të pretenduara.
  - Vërtetimi mbi të drejtat pronësore mbi paluajtshmëritë nr. 4013/2014 e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Vitisë, me 24 shtator 2014, që i rëndit pronat e pretenduara nën emrin e ndërmarrjes “Agromorava”,
5. Me 30 mars 2015, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës me vendimin nr. KPCC/D/A/267/2015 e ka hedhur poshtë kërkesën. Në paragrafët 19 dhe 20 të Vendimit grupor, i cili sipas Vendimit të Certifikuar vlen konkretisht për kërkesat në fjalë, thuhet se sipas përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pronat e kërkuara në vitin 2002 janë vendosur nën administrim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit ( dhe rrjedhimisht pasuesit të tij Agjencisë Kosovare të Privatizimit) përmes miratimit të rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut 2005/18. Sipas përfaqësuesit, ndërmarrja “Agromorava” është në procedurë të likuidimit prandaj pronat e kërkuara bien ekskluzivisht nën kompetencën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c) dhe nenit 5.1 (a) të rregullores së UNMIK-ut 2008/4 për Dhomën e Posaçme. Në këto rrethana, Komisioni gjen se mbajtësi i pretenduar i të drejtave pronësore nuk e ka humbur të mundësin e tij për të ushtruar të drejtën e vet

si pasojë e konfliktit të viteve 1998/1999, por si pasojë e procesit pasues të privatizimit, rrjedhimisht, Kërkesa bie jashtë kompetencës së Komisionit. Komisioni vë në pah se Vendimi nuk paragjykon të drejtën e palës kërkuese që të kërkoj zgjidhje pranë Gjykatës kompetente.

6. Vendimi iu është dorëzuar Palës Ankuese me 4 qershor 2015. Ai ka dorëzuar një ankesë me 25 qershor 2015.

### **Pretendimet e palës ankuese**

7. Pala Ankuese thekson se vendimi i Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës përmban shkelje esenciale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale si dhe vërtetimin e gabuar të fakteve.
8. Pala ankuese pretendon se nuk është e vërtetë që familja e tij nuk e ka humbur posedimin mbi pronën e pretenduar për shkak të konfliktit.
9. Pala Ankuese pretendon se familja e tij e ka fituar të drejtën pronësore mbi pronën e pretenduar në vitin 1994 sipas aktgjykimit nr. 155/90.
10. Sipas Palës Ankuese, fakti se ai nuk është i regjistruar në librat kadastral si pronar i pronës së pretenduar nuk mund të jetë arsye për hedhjen poshtë të kërkesës së tij,
11. Sipas të lartcekurave, Pala Ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të anulohet vendimin e KKKPK-së që të konfirmoj të drejtën e riposedimin në emrin e tij.

### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e Ankesës**

12. Ankesa është parashtruar brenda 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

#### **Meritat e ankesës**

13. Gjykata Supreme e ka shqyrtuar vendimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për procedurën kontestimore nr. 03/L-006 (tutje: LPK), dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të palës përgjegjëse në ankesë, ka gjetur se ankesa është e pabazë.
14. Gjykata Supreme gjen se KKKPK-ja ka marr vendim të saktë kur ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të kompetencës së saj.
15. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, Paraqitësi i kërkesës ka të drejtën e urdhrorit nga Komisioni për riposedim të pronës nëse Paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën private apo të drejtat e shfrytëzimit mbi pronën e paluajtshme, mirëpo që ai apo ajo nuk kanë mundur të ushtrojnë të drejtat pronësore në fjalë për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë janë të ndërlidhura apo janë pasojë e konfliktit të armatosur. në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

16. Së pari, Pala Ankuese pretendon se familja e tij e ka fituar të drejtën e pronësisë sipas aktgjykimit nr. 155/90, të lëshuar nga Gjykata Komunale Vitisë.
17. Sipas nenit 20 të ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore (gazeta zyrtare nr. 6/80) që ka vlejtur në kohën e aktgjykimit nr. 723/90, që është nxjerr (në vitin 1993), e drejta pronësore mund të fitohet me ligj, sipas punës juridike ( transferit ligjor) apo trashëgimisë.
18. Por, neni 33 i Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore (GZ RSFJ nr. 6/80) përcakton se në bazë të punës juridike e drejta pronësore mbi paluajtshmerinë do të fitohet me regjistrimin e tillë në “librat publik të noterisë” (librat kadastral) apo në ndonjë mënyrë tjetër siç përcaktohet me ligj.
19. Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ka gjetur *ex officio* se Certifikata mbi të drejtat e pronësore mbi paluajtshmeritë e cila pasqyron pronën e pretenduar të regjistruar në emrin e ndërmarrjes “Agromorava”.
20. Kjo shpie në përfundimin se familja e palës ankuese nuk ka fituar të drejtën pronësore meqë kushtet e nenit 33 të Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore (RSFJ nr. 6/80) nuk është përmbushur.
21. Prona e pretenduar ka qenë dhe është akoma e regjistruar nën emrin e ndërmarrjes “Agromorava”, që do të thotë që ka qenë dhe pronë shoqërore. Në pajtim me nenin 321, paragrafin 1 të LPK, nuk është e nevojshme të provohen faktet e njohura botërisht dhe as faktet që janë provuar më aktgjykime të mëparshme të gjykatës.
22. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtës pronësore mbi pronën shoqërore dhe/ose pronën shtetërore nuk është kompetencë e KKPK-së, përkatësisht Kolegjit të Ankesave të KPA-së.
23. Gjykata Supreme gjen se nuk është bërë ndonjë shkelje e të drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve.
24. Në pah të lartcekurave, në pajtim me nenin 13.3, pika (c) të Ligjit nr. 03/L-079, vendoset si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të atakohet me mjetet të zakonshme apo jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Ragip Namani, Gjyqtar**

**Timo Eljas Torkko, Referent i EULEX-it**